



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2023:250400

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05644029

P.nr. 535/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Besnik Sheqiri, me procesmbajtëse Erblina Aliu, në çështjen penale kundër të pandehurit B. S., për shkak të veprës penale “Vjedhja e pyllit” nga neni 349 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr. 6193/23, të datës 15.11.2023, menjëherë pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 30.04.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Rukije Sheshivari dhe të pandehurit, mori dhe publikisht shpalli dhe të njëjtën ditë përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

B. S. nga i ati Sh. dhe ëma F., mbiemri i vajzërisë B., i lindur më datë ..., me nr. personal të letërnjoftimit ... me vendbanim në fshatin P. të Komunës së P., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Sepse:

Me datën 10.09.2023, rreth orës 14:30, me qëllim të vjedhjes kishin shkuar në pyll, në Rajonin Ekonomiko Pyjor të T. në vendin e quajtur M. të Komunës së P., me ç ‘rast ishte haset duke prere me moto sharrë dru zjarri trungje rreth ... cope, me dimensione te gjata ... m - të llojit ahu, me vëllim të përgjithshëm prej më shumë se ... m³ (katër metër kub), me ç ‘rast të dëmtuarës Ekonomisë Pyjore të Komunës së P. ju ka shkaktuar dëm material.

- me këtë ka kryer veprën penale “Vjedhja e pyllit” nga neni 349 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit si më lartë dhe neneve 4 par. 1 nën-par. 1.4, 7, 17, 21, 69, 70, 81 dhe 82 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 367, 452 par. 4, 462, 498 dhe 499 të KPRK-së, të pandehurit i shqipton:

VËREJTJE GJYQËSORE

I. Me këtë vërejtje gjyqësore të pandehurit i bëhet me dije se ka kryer veprë të dëmshme penale dhe të rrezikshme që përben veprë penale dhe nëse i njëjti kryen prapë veprë të tillë, gjykata do t'i shqiptoj sanksion më të rëndë penal.

II. I pandehuri lirohet nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale, ngase i njëjti është përfitues i skemave sociale, dhe se pagesa e tyre do të rrezikonte gjendjen materiale të saj ose të personave që detyrohet t'i mbështes materialisht.

III. I dëmtuari ekonomia pyjore e Komunës së P., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP.II.nr.6193/23, të datës 15.11.2023 kundër të pandehurit B. S., për shkak të veprës penale "Vjedhja e pyllit" nga neni 349 par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 30.04.2024, në të cilën pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi është bindur se i pandehuri ka kuptuar aktakuzën, në kuptim të nenit 241 par. 4 të KPP-së, të njëjtëve u ka ofruar mundësinë e deklarimit rreth fajësisë - të pranojë fajësinë për veprën penale për të cilën janë akuzuar apo të deklarohen të pafajshëm.

I pandehuri B. S. në seancën e shqyrtimit fillestar, me rastin e deklarimit të tij rreth fajësisë për veprën penale për të cilën është akuzuar, ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, ka shprehur keqardhje për veprimet e tij, është përfitues i skemave sociale, mbajtës i familjes, premtan se në të ardhmen nuk do të përsëritet më një veprim i tillë.

Gjyqtari i vetëm gjykues konstaton se i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike, andaj gjatë marrjes në konsideratë të pranimi të fajësisë nga i pandehuri, mori pikëpamjet e prokurorit të shtetit.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga të pandehurit, sepse të njëjtit pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe si i tillë gjen mbështetje në provat që gjinden në shkresat e lëndës dhe është në përputhje me dispozitat e KPP-së, gjykatës i propozoi që ta aprovojë si të tillë.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas pranimi të fajësisë nga të pandehurit dhe marrjes në konsideratë të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, është pranuar edhe gjendja faktike si në aktakuzë, prandaj është konsideruar se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është vullnetar dhe i sinqertë dhe duke qenë si i tillë nuk ka pengesa ligjore.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i pandehuri, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi se në veprimet e të pandehurit të ndërrmarra

në kuadër të dashjes së tij, manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale “Vjedhja e pyllit” nga neni 349 par. 1 të KPRK-së, andaj pasi që më parë gjeti se në aspektin penalo-juridik është përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor dhe iu shqiptoi sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat e mundshme lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që si rrethana lehtësuese mori parasysh faktin se i pandehuri në shqyrtimin fillestar ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë, është penduar, ndjenë keqardhje për veprimet e tij, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, përveç rrethanave të sipër theksuara, si rrethanë lehtësuese gjykata mori parasysh edhe faktin se i njëjti është mbajtës i familjes, baba i gjashtë (6) fëmijëve, përfitues i skemave sociale e lëshuar nga Qendra për punë sociale – P., me numër të regjistrimit ..., të lëshuar me datë 01.02.1984, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, andaj vlerësoi se sanksioni penal i shqiptuar të pandehurit është në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tij, me bindje se me një sanksion të tillë penal do të arrihet qëllimi i vërejtjes gjyqësore, i paraparë me nenin 81 të KPRK-së, me të cilin kryesisht i jepet vërejtja dhe i bëhet me dije se ka kryer një veprë të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbënë veprë penale dhe nëse kryen prapë veprë të tillë, gjykata do të shqiptojë sanksion më të rëndë penal.

Vendimi mbi lirimin nga detyrimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale është marrë në bazë të nenit 452 par. 4 të KPP-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt juridiko civil është marrë në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 81 dhe 82 të KPK-së, si dhe neneve 242 dhe 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal
P.nr. 535/23, datë 30.04.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues
Besnik Sheqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.